



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:164556

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05764263

CN.nr.81/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, me bashkëpunëtoren profesionale H.D. në çështjen juridike jokontestimore, sipas propozimit të propozuesit A.H. me numër personal nga fshati Nashec, komuna e Prizrenit, për përmirësimin e gabimit teknik në kontratë, jashtë seancës, më datë 31.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. HEDHET POSHTË propozimi i propozuesit A.H. nga fshati Nashec, komuna e Prizrenit, me numër CN.nr.81/2022, i datës 04.03.2022, për përmirësimin e gabimit teknik në kontratë, si i palejuar.

A r s y e t i m

Propozuesi A.H. nga fshati Nashec, komuna e Prizrenit, pranë kësaj gjykate me datë 04.03.2022, ka parashtruar propozimin për përmirësimin e gabimit teknik në kontratë. I njëjti ka theksuar se me kontratën për shitblerjen e paluajtshmërisë OV.br.2761/85, datë 19.09.1985, është përvjedhur një gabim teknik në emrin e babës së blerëses që është shënuar “.....”, e duhet të qëndroj Gj.S.H., pra emri i babës ka qenë bashkëshorti i Gj.. Duke kërkuar kështu që të përmirësohet gabimi teknik në emrin e babait të kontraktueses Gj. e që duhet të jetë S.

Gjykata pasi bëri shqyrtimin paraprak të propozimit, konform nenit 18 par.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), i cili ka përcaktuar se: “Gjykata, sipas detyrës zyrtare, gjatë gjithë procedurës kujdeset nëse zgjidhja e kontestit hynë ose jo në kompetencën gjyqësore”, ndërsa neni 391 pika a), e LPK-së, ka përcaktuar se: “Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: a) çështja e ngritur me padi nuk hynë në kompetencën gjyqësore..”, e lidhur me nenin 3 të Ligjit të Procedurës Jokontestimore, i cili ka përcaktuar se: “Në procedurën jokontestimore përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurën kontestimore, po qe se me këtë

ligj nuk është paraparë ndryshe”, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke e hedhur poshtë si të palejuar propozimin e propozuesit A.H. për përmirësimin e gabimit teknik në kontratë.

Gjykata vlerësoi se kontrata përmirësimin e të cilës e kërkon këtu propozuesi, është një dokument i cili është nënshkruar me vullnetin e vet palëve, pastaj sipas dispozitave ligjore në fuqi, në kohën e përpilimit të kontratës (Ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve, aprovuar nga Kuvendi RSFJ, në seancën e Dhomës Federative datën 30 mars 1978), në nenin 72 par.2, ka përcaktuar se: *“Kontraktuesi që nuk di të shkruajë do të vejë në dokument shenjen e gishtit të vërtetuar nga dy dëshmitarë ose nga gjykata apo nga organi tjetër”*, dhe me shikimin në kontratën e cila është në shkresat e lëndës konstatohet se e njëjta ka shenjen e gishtit të kontraktueses Gj.H. dhe nënshkrimin e kontraktuesit N.H. si dhe e njëjtë është e vërtetuar në Gjykatë.

Po ashtu, bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit të Procedurës Kontestimore, gjykata është kompetente që të bëjë përmirësimin e gabimeve teknike në Aktvendimet dhe Aktgjykimet e lëshuara nga Gjykata, mirëpo jo përmirësimin e gabimeve teknike në punët juridike në mes të palëve.

Bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit të Procedurës Jokontestimore, është rregulluar procedua për përpilimin dhe vërtetimin e përmbajtjes së dokumenteve, për ruajtjen e dokumenteve, si dhe anulimin e dokumenteve, e jo korigjimin e tyre, apo përmirësimin e gabimeve teknike.

Andaj, duke marrë parasysh të lartcekurat, konform nenit 18 par.2 dhe nenit 391 pika a) të LPK-së, e lidhur me nenin 3 të LPJK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-divizioni civil
CN.nr.81/2022, me datë 31.05.2024

G j y q t a r i

Taulant Rexhëbeqaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate Themelore.